



Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim

Resource Center for Learning and Consulting

Lef Nosi

Rr. Zahir Pajaziti p.n. 20000 Prizren, Kosovë • Tel.: +383 (29) 241 037

---

## **Njësia mësimore: Ne dhe rregullat**

---

### **Rrezultatet e pritura:**

- të kuptojë se çka janë rregullat
- të shpjegojë se pse janë të rëndësishme rregullat në shoqëri
- të dallojë se si zbatohen rregullat nga shenja të caktuara

### **Materiali i nevojshëm:**






- Libri
- fotografi të ndryshme
- fleta e bardhë
- lapsi
- ngjyra druri

### **Përshkrimi i aktiviteteve:**

Shoqëria njerëzore ngrihet mbi rregulla dhe ligje, të cilat duhet të zbatohen nga të gjithë. Në shkollë ka rregulla të përcaktuara në rregulloren e shkollës. Edhe familja ka rregullat e veta. Loja ka rregulla për të përcaktuar drejtë fituesit. Me kalimin e kohës disa rregulla nuk përdoren më. Në vend të tyre njerëzit krijojnë rregulla të reja, të cilat njerëzit nuk mund t'i ndryshojnë sipas dëshirës së njëri apo tjetrit.

## Aktiviteti 1:

Lidh përshkrimet e rregullave me figurat e mëposhtme:

		<b><u>DËGJONI PERSONIN QË ËSHTË DUKE FOLUR</u></b>
		<b><u>MOS FOL ME ZË TË LARTË</u></b>
		<b><u>FLISNI ME RADHË</u></b>
		<b><u>HIDHNI MBETURINAT NË SHPORTË</u></b>
		<b><u>NDALOHET PËRDORIMI I CELULARIT NË SHKOLLË</u></b>

## **Aktiviteti 2:**

Shkruani dhe vizatoni disa rregulla që i njihni ju, çiftë në familje, në shkollë, në rrugë, në spital, etj.

A large empty rectangular box with a thin black border, intended for the student to draw and write their own rules. The box is currently blank.